



Pranuar / Dorëzuar Priljena / Prodato Received / Delivered	27-07-2022	2	viti god year
Organ / Mjesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	4373/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.527/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.527/2022 të datës 13.06.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me numër:113/2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i datës 12.05.2022, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.527/2022 e datës 13.06.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër:113/2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i datës 12.05.2022 si dhe rekomandimi numër:63 i datës 21.04.2022 i Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e ankueses.
- III. OBLIGOHET Komisionin i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të *rishqyrtojë* lëndën e ankueses lidhur me transferimin e saj.
- IV. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Arsyetim

Ankuesja, e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kundër Vendimit Nr.113/2022 për transferim të datës 12.05.2022 të Zv/Drejtoreshës së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se pozita në të cilën është transferuar ankuesja, kualifikimi dhe përvoja e punës nuk i përshtaten kushteve dhe kriterëve të veçanta të përcaktuara në nenin 54 paragrafi 3 të Ligjit për Zyrtarët Publik, me arsyetimin se për pozitën në të cilën ankuesja është transferuar kërkohet përgatitja apo kualifikimi universitar në studimet për drejtimit Gazetari/Komunikim Masiv, Gjuhës dhe Letërsisë, Marrëdhëniet Ndërkombëtare ose ekuivalente dhe tre (3) vite përvojë pune.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli, me datë 08.07.2022 me numër protokoll 3993/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.527/2022 të datës 13.06.2022, me numër protokoll 3414/2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 13.05.2022 dërguar nga arkiva e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për ankuesen; Vendimit me numër:113/2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i datës 12.05.2022; Kriteret e kërkuara për pozitën Zyrtar i/e Lartë për Komunikim me Publikun; Akt emërimit e ankueses i datës 29.03.2012 me numër: 226/2012; Vërtetimin e datës 07.09.2021; Vërtetimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore i datës 08.09.2021 me numër:179/2021; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 07.07.2020 me numër:03/09; E-mailin e ankueses të datës 19.04.2022 dërguar V.B; E-mailin e datës 15.04.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuese; Autorizimin e datës 13.06.2022; Diplomën e ankueses të datës 02.07.2012 me numër 212/0712; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në kërkesë të datës 08.07.2022; E-mailin e datës 05.07.2022 dërguar nga K.K në Këshilli; Vendimin e datës 24.02.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të jashtme dhe Diasporës; E-mailin e datës 11.03.2022 dërguar nga S.K për V.B; Autorizimin për publikimin e konkursit i datës 01.08.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun; Shkresën e pozitive të lira; Çertifikatën e ankueses të datës 08.11.2017; Çertifikatën e ankueses të periudhës muajit qershor 2017; Çertifikatën e ankueses të datës 01.02.2016; Çertifikatën e ankueses të muajit maj 2016; Çertifikatën e ankueses me numër reference:2013.19.18-28-47; Çertifikatën e ankueses të muajit shkurt 2012; Çertifikatën e ankueses të muajit shkurt (datë 07-09) të vitit 2012; Çertifikatën e ankueses të muajit maj (datë 05.06) të vitit 2011; Çertifikatën e ankueses të datës 21.12.2011; Çertifikatën e ankueses të datës 28.02.2008 me numër prot:23; Çertifikatën e ankueses të datës 29.12.2004; Vendimin e Këshillit A.nr.461/2022 të datës 07.07.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses

*është e bazuar*, ndërsa lënda i kthehet në *ri-shqyrtim dhe ri-vendosje* Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, *sepse*:



Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja në bazë të vërtetimit të datës 08.09.2021 me shifër Nr.179/2021 është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, në pozitën: "Zyrtare e Lartë Ndërlidhëse me Ministrinë pranë Departamentit për Çështje Rajonale", ndërsa përmes Vendimit me Nr.113/2022 për transferim të datës 12.05.2022 të Zv/Drejtoreshës së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme është transferuar në pozitën "Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun, Divizioni për Komunikim me Publikun në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës" për shkak të ristrukturimit të institucionit, respektivisht Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas rekomandimit të Komisionit të Ri-strukturimit të datës 21.04.2022.

Po ashtu Kolegji ka konstatuar se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e kishte njoftuar ankuesen me datë 15.04.2022 nëpërmjet e-mailit se për shkak të ri-strukturimit të institucionit se pozita të cilën e ka mbajtur ankuesja më nuk do të ekzistojë duke i kërkuar të njëjtës të shpreh interesin për tri (3) propozime/pozita të së njëjtës kategori më vërejtën se përcaktimi juaj nuk ka karakter obligues për vendimmarrjen e Komisionit të Ri-strukturimit, ndërsa ankuesja me datë 19.04.2022 nëpërmjet e-mailit ka shprehur interesin që të sistemohet në pozitë ekuivalente në njërin nga tre (3) departamentet/divizionet, si vijon: 1. Departamenti për Evropë, BE dhe Rajon; 2. Divizioni për Evropë dhe BE; 3. Divizioni për Rajon.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i këshillit ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 54 paragrafi 1 dhe 3 ku përcaktohet se: "1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrtton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit", ndërsa sipas Autorizimit për shpalljen e konkursit të datës 01.08.2019 të ofruar në cilësi të provës materiale nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD-së, Kolegji ka gjetur se për pozitën në të cilën është transferuara ankuesja sipas rekomandimit të Komisionit të Rekrutimit "Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun", kërkohen këto shkathtësi: 1. Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik, shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit; 5. Së pakur 3 vite përvojë pune profesionale; 6. Diploma Universitare, Gazetari, Shkenca Politike ose Gjuhë dhe Letërsi Shqipe", andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se arsyetimi i dhënë përmes shkresës së datës 08.07.2022 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është i paqëndrueshëm, ngase pavarësisht se për pozitën në fjalë kërkohet edhe kualifikimi/Diploma Universitare në fushën Shkencave Politike të cilën ankuesja sipas Diplomës të datës 02.07.2012 e ka të përfunduar, mirëpo në rastin konkretë për pozitën që është transferuara kërkohet së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik, andaj Komisioni i Rekrutimit me rastin e përpilimit të raportit të datës 21.04.2022 me propozimin e dhënë, respektivisht edhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e nxjerrjes së vendim për transferimin e ankueses në pozitën "Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun" kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 54 paragrafi 3, pasi që ankuesja nuk i ka plotësuar kërkesat e veçanta, respektivisht nuk i ka tre (3) vite përvojë punë profesionale në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mbi bazën e të gjeturave dhe konstatimeve të pasqyruara si më lartë në këtë vendimi, konstaton se ka bazë të mjaftueshme që lënda e ankueses të kthehet në ri-shqyrtim dhe ri-vendosje tek Komisioni i Ristrukturimit, ndërsa propozimi i datës 21.04.2022 përmes rekomandimit me numër:612 është i paqëndrueshëm dhe i njëjti është në kundërshtim me nenin 54 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht tani e tutje bie poshtë, dhe po ashtu për të njëjtat arsye Vendimi Nr.113/2022 për transferim i datës 12.05.2022 i nxjerre nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa Komisioni i Ristrukturimit me rastin e ri-shqyrtimit të lëndës për propozimin e transferimit të ankueses duhet të merr për bazë vërejtjet e dhëna në këtë vendim dhe të veprojë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e aplikuara ligjore që përcaktojnë qartë kriteret e marrjes së veprimeve administrative lidhur me transferimin e nëpunësve civil në rastin e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, njëkohësisht për pozitën që synohet të transferohet e njëjta duhet t'i përmbush kërkesat e veçanta, gjegjësisht kualifikimin e nevojshëm dhe përvojën e punës profesionale.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër **A.nr.527/2022**

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Estref SHABANI**

Kryetari i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivit të KPMSSHCK-së

